

Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

për

“Kastriot Dibra” B.I.



Biznesi për shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit

Shtator, 2025

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit
“Kastriot Dibra” B.I. është hartuar nga Hana Zeka me qëllim të marrjes së Pëlqimit Mjedisor.

Aplikuesi:

“Kastriot Dibra” B.I.

Adresa: Rr. “Azem Bejta”, p.n., Skenderaj

Tel +38349588883

E-mail: kdibra@hotmail.com

Hartuese e raportit:

Hana Zeka (*Eksperte e licensuar nga MMPHI për hartimin e raporteve të VNM-së*)

Adresa: Rr. “Feriz Blakqori”, P-N2, Tophane, Prishtinë, Kosovë

Tel.: +383 49 707 089

E-mail: hana.zeka@ozon-space.com



Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Baza ligjore	5
3. Metodologjia e punës	6
4. Përshkrimi i lokacionit të projektit dhe kushteve mjedisore ekzistuese	8
Pozita gjeografike e lokacionit.....	8
Hidrografia	10
Përshkrimi Teknik i projektit	11
Specifikacioni Teknik	11
5. Ndikimet e Identifikuara Mjedisore dhe Masat për Minimizimin e Ndikimeve	12
Ndikimet në ajër.....	12
Ndikimet në ujë.....	13
Ndikimet në tokë.....	13
Ndikimet në biodiversitet.....	13
Trajtimi dhe deponimi i mbeturinave	13
Zhurma	15
Zjarri	15
6. Masat për Zbutjen e Ndikimeve Mjedisore	15
7. Konkluzione dhe rekomandime	19

Lista e Figurave

Figura 1 Ortofoto të lokacionit të projektit	8
--	---

Lista e Tabelave

Table 1 Ndarja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	14
Table 2 Masat e nevojshme për Mbrojtjen e Mjedisit	16

1. Hyrje

Ky dokument paraqet një raport të përmbledhur të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për biznesin i cili bënë shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit, “Kastriot Dibra” B.I.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për “Kastriot Dibra” B.I. Fushë Kosovë, me pronar Z. Kastriot Dibra, paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor, si dokument i nevojshëm për marrjen e pëlqimit për biznesin “Kastriot Dibra” B.I. në parcelën P-72514009-00708-3 në zonën kadastrale Sllatinë e madhe, në komunën e Fushë Kosovës.

Me qëllim që të identifikohen dhe analizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten gjatë funksionimit të biznesin “Kastriot Dibra” B.I. Fushë Kosovë në mjedis, është bërë përshkrimi i lokacionit të biznesit, përshkrimin i projektit dhe masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku do ushtrohet kjo veprimtari.

Raporti është përgatitur sipas kërkesave të kornizës ligjore mjedisore të Kosovës, veçanërisht sipas Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis - Ligji Nr.08/L-181.

Raporti përshkruan:

- Gjendjen e përgjithshme në dhe rreth lokacionit;
- Kushtet mjedisore ekzistuese;
- Përshkrimi Teknik i projektit dhe punimet të cilat kryhen;
- Ndikimet e mundshme të projektit në mjedis;
- Identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve dhe ndërmarrja e masave adekuate për evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij biznesi në mjedis janë komponentët kryesore të këtij raporti.

Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me investitorin, prej të cilit janë marrë të dhënat kryesore dhe të nevojshme përmes takimeve dhe bisedave.

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna nga përshkrimi teknik i projektit si dhe të dhëna dhe materiale për projekte të ngjashme, janë realizuar vizita në lokacionin e projektit dhe janë bërë fotografi për hartimin e këtij raporti.

Territori apo zona në studim nuk është i përfshirë në ndonjë zonë të mbrojtur, monument natyrore, park natyral, rezervat apo park kombëtar. Pra me këtë raport mjedisor do të ofrohen informata të mjaftueshme për zonën ku shtrihet projekti, procesin, ndikimet e tij në mjedisin e afërt dhe zonën më të gjër, si dhe masat mjedisore që ndërmerren gjatë zhvillimit të aktiviteteve të këtij projekti dhe ndikimeve eventuale që do të mbesin pas.

2. Baza ligjore

Bazë për hartimin e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2023 me Nr.08/L-181. Ky ligj përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka për qëllim që të siguroj një vlerësim të qartë të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Për përgatitjen e këtij raporti janë shfrytëzuar legjislacioni ekzistues i Republikës së Kosovës si dhe rregullat relevante dhe praktikatat e mira nga vendet e ndryshme të BE-së, direktivat përkatëse për mjedis siç është Direktiva e VNM-së, dhe Direktiva e Habitave 92/43/EEC, 1992. Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për biznesin shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181
- Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji Nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102.

- Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri Nr. 04/L-012
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

3. Metodologjia e punës

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis (VNM) si dhe për të identifikuar masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për zonën e biznesit “Kastriot Dibra” i cili ndodhet në qytetin e Fushë Kosovës, saktësisht në zonën kadastrale Sllatinë e madhe, në parcelën P-72514009-00708-3, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyrë, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme sipas fazave.

Përshkrimin e kushteve mjedisore ekzistuese duke marrë parasysh aspektet mjedisore të listuara si në vijim:

- Pozitën gjeografike të lokacionit;
- Topografinë e lokacionit;
- Biodiversitetin në lokacion;
- Karakteristika pedologjike;
- Shfrytëzimin e tokës;
- Hidrologjinë në lokacion;
- Kushtet Klimatike;
- Kualitetin e Ajrit;
- Erozionin;
- Vërshimet;
- Zonat e Mbrojtura Natyrore;
- Popullsia;
- Infrastruktura.

Pas një analize të gjendjes ekzistuese mjedisore në lokacion, specifikacionin teknik të projektit, janë identifikuar ndikimet potenciale mjedisore si vijon:

- Ndikimet në cilësinë e ajrit;

- Ndikimi në mjedisin ujor;
- Ndikimet në tokë;
- Ndikimi nga gjenerimi i mbeturinave;
- Ndikimi nga zhurma;
- Ndikimet në biodiversitet;
- Ndikimet në peizazh;
- Ndikimet sociale;
- Siguria dhe shëndeti në punë;
- Ndikimi në trashëgiminë kulturore.

Këto ndikime janë vlerësuar, dhe janë parashtruar masat për zbutjen, minimizimin edhe kontrollimin e këtyre ndikimeve. Është realizuar një Plan i Monitorimit Mjedisor me qëllim të monitorimit dhe implementimit të masave zbutëse të ndikimeve mjedisore.

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion,
- Karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit,
- Klima dhe të dhënat meteorologjike,
- Kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion,
- Biodiversiteti në lokacionin e projektit.
- Vlerësimi i ndikimeve sipas kriterëve në vijim:
- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit,
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti,
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës,
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes.

Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet/ të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

4. Përshkrimi i lokacionit të projektit dhe kushteve mjedisore ekzistuese

Pozita gjeografike e lokacionit

Biznesi “Kastriot Dibra” B.I. me aktivitetet kryesor shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit, është objekt ekzistues në qytetin e Fushë Kosovës, zona kadastrale Sllatinë e madhe, parcela që planifikohet të përdoret në këtë projekt është: P-72514009-00708-3. Objekti që operon biznesi “Kastriot Dibra” B.I. është objekt ekzistues.



Figura 1 Ortofoto të lokacionit të projektit

Komuna e Fushë Kosovës gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, me një sipërfaqe prej rreth 83 km². Në këtë territor përfshihen qyteti i Fushë Kosovës dhe mbi 15 fshatra përreth. Sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të vitit 2011, komuna kishte rreth 34,827 banorë. Në vitin 2019, sipas Institutit GAP dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i banorëve ishte rritur në afërsisht 38,960. Regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2024 tregoi një rritje të konsiderueshme, duke e çuar numrin e banorëve në 64,078. Përbërja etnike e popullsisë ka qenë e larmishme. Shqiptarët përbëjnë shumicën, ndërsa

komunitetet tjera përfshijnë ashkalitë, romët, serbët, egjiptianët dhe një numër më të vogël të turqve, boshnjakëve e goranëve. Kjo e bën Fushë Kosovën një nga komunat me diversitet më të lartë etnik në Kosovë.

Komuna e Fushë Kosovës ka një rëndësi të veçantë strategjike për shkak të pozitës së saj gjeografike dhe zhvillimit të infrastrukturës. Ajo përfaqëson një nyje të rëndësishme hekurudhore, pasi nga këtu kalojnë linjat kryesore që lidhin Prishtinën me Mitrovicën, Pejën, Shkupin dhe Prizrenin. Gjithashtu, në territorin e komunës ndodhet Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, i cili ndodhet në fshatin Sllatinë e Madhe dhe është porta kryesore ajrore e Kosovës. Përveç kësaj, komuna është e lidhur me rrugë nacionale të rëndësishme, si autostrada M9 (Prishtinë–Pejë–Podgoricë) dhe rruga M2, që i japin një rol të veçantë në zhvillimin e transportit dhe tregtisë.

Në aspektin e shërbimeve publike, infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimit është e zhvilluar në shkallë të lartë. Rreth 87% e popullsisë së komunës ishte e lidhur me rrjetin e ujësjellësit në vitin 2011, duke e renditur komunën ndër më të zhvilluarat në këtë fushë. Megjithatë, menaxhimi i mbeturinave ka pasur sfida, duke u vlerësuar me cilësi mesatare në nivel vendi. Për nga arsimi, Fushë Kosova ka një numër të madh shkollash fillore dhe të mesme, ndërsa popullsia shkollore është rritur me mbi 17% nga viti 2008 deri në vitin 2019. Raporti nxënës–mësimdhënës është ndër më të lartët në Kosovë, duke arritur nivelin 1:24, çka tregon për nevojën e shtimit të kapaciteteve mësimore.

Ekonomia lokale mbështetet kryesisht në sektorin privat. Brenda territorit të komunës operojnë mbi 3,000 biznese, të cilat punësojnë mbi 9,000 persona. Në sektorin publik janë të punësuar rreth 773 persona. Gjithashtu, komuna ka mbi 10,000 kontribuues në Fondin Pensional të Kursimeve. Këto shifra tregojnë për një zhvillim të ngadaltë por të qëndrueshëm ekonomik, i mbështetur kryesisht nga afërsia me kryeqytetin Prishtina dhe nga infrastruktura transportuese e favorshme.

Në aspektin e trashëgimisë kulturore dhe historike, në territorin e komunës ndodhet Kalaja e Harilaqit, një lokalitet arkeologjik i rëndësishëm që daton nga periudha parahistorike dhe periudha bizantine. Ky monument është një dëshmi e rëndësishme e historisë së hershme dhe përfaqëson potencial turistik për komunën.

Në përmbledhje, Fushë Kosova është një komunë në zhvillim me një popullsi që po rritet me ritme të shpejta, një përbërje etnike të larmishme dhe një infrastrukturë të pozicionuar në mënyrë strategjike.

Pozita e saj në qendër të Kosovës, pranë kryeqytetit, dhe prania e Aeroportit Ndërkombëtar e bëjnë këtë komunë një qendër të rëndësishme për transport, tregti dhe zhvillim ekonomik. Megjithatë, sfidat mbeten në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave, uljen e raportit nxënës–mësimdhënës dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për një popullsi që po shtohet vazhdimisht.

Hidrografia

Territori i Fushë Kosovës shtrihet në një fushë të gjerë aluvionale në afërsi të kryeqytetit Prishtina. Hidrografia e komunës dominohet nga prania e lumenjve të vegjël dhe rrjedhave sezonale, të cilat janë degë të Lumbardhit të Prishtinës (i njohur edhe si Prishtevka), që derdhet në Sitnicë. Lumi Sitnica, lumi më i gjatë në Kosovë, kalon shumë pranë territorit të komunës dhe ka ndikim të madh në sistemin ujqor të zonës. Për shkak të relievit të ulët dhe tokave aluvionale, në disa pjesë të territorit ka prezencë të përkohshme të ujërave të sipërfaqshme gjatë stinëve me reshje të dendura. Hidrografia e komunës është e kufizuar, por e lidhur ngushtë me pellgun e Sitnicës, që përbën boshtin kryesor ujqor të Rrafshit të Kosovës.

Ajri

Komuna e Fushë Kosovës përballet me sfida të ndotjes së ajrit, sidomos për shkak të afërsisë me Prishtinën dhe me termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” që ndodhen në Obiliq, vetëm disa kilometra larg. Pozita e komunës në një fushë të hapur, ku shpesh mungon qarkullimi i mjaftueshëm i ajrit, e përkeqëson grumbullimin e ndotësve. Burime të tjera të ndotjes janë trafiku i dendur, djegia e lëndëve djegëse për ngrohje dhe aktivitetet ndërtimore. Për shkak të relievit të ulët, inversioni termik gjatë stinës së dimrit shpeshherë e mban ndotjen e ajrit të përqendruar mbi zonën e Fushë Kosovës, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e banorëve. Megjithatë, përveç ndikimit antropogjen, zona karakterizohet nga klimë kontinentale me verë të nxehtë dhe dimër të ftohtë, gjë që ndikon edhe në cilësinë sezonale të ajrit.

Erërat

Në Fushë Kosovë, erërat dominohen nga qarkullimi tipik i Rrafshit të Kosovës. Drejtimet më të shpeshta të erërave janë nga verilindja dhe jugperëndimi. Këto erëra ndikojnë në shpërndarjen e ndotësve të ajrit, por nuk janë të mjaftueshme për të ulur ndotjen në periudhat me stabilitet atmosferik. Shpejtësia e erës zakonisht është mesatare (2–4 m/s), me periudha më intensive gjatë pranverës dhe vjeshtës, kur ka më shumë turbulenca atmosferike. Në verë, erërat e lehta nga jugu dhe jugperëndimi

shpesh sjellin temperatura më të larta, ndërsa në dimër erërat nga verilindja sjellin masa ajrore të ftohta. Në përgjithësi, fusha e hapur lejon qarkullim relativ të mirë të erës, por prezenca e bllokimeve termike dhe e ndotjes industriale në afërsi shpesh i zvogëlon efektet pozitive të tyre në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Përshkrimi Teknik i projektit

Specifikacioni Teknik

Biznesi është i fokusuar në shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstit që konfiskohet nga autoritetet shtetërore, kryesisht nga Dogana dhe inspektoratet përgjegjëse. Qëllimi i veprimtarisë është që mallrat e konfiskuara, të cilat nuk lejohen të qarkullojnë në treg, të bëhen plotësisht të papërdorshme dhe të mos rikthehen kurrë në përdorim apo në shitje.

Procesi i shkatërrimit bëhet në menyrë manuale - mekanike përmes gërshëreve ku copëtohet dhe dëmtohet tekstili në atë mënyrë që ai nuk mund të rikonstruktohet më si produkt i plotë. Ky proces garanton siguri të plotë, transparencë dhe përputhje me ligjin.

Ky proces zhvillohet në prani të përfaqësuesve të autoriteteve kompetente për të garantuar transparencë.

Materiali i copëtuar mund të destinohet për riciklim (p.sh. për mbushje industriale, përpunim tekstili apo lëndë të parë sekondare), gjithmonë duke respektuar ligjin dhe duke siguruar që asnjë pjesë e mallrave të konfiskuara të mos kthehet në treg.

Pas çdo procesi shkatërrimi, lëshohet certifikatë zyrtare e shkatërrimit, e cila i dorëzohet autoriteteve shtetërore si dëshmi e përfundimit të procedurës. Shkatërrimi kryhet me makineri të dedikuara për tekstil, të cilat plotësojnë kriteret e sigurisë industriale.

Sigurohet që asnjë pjesë e produktit të konfiskuar të mos rikthehet në qarkullim, duke mbrojtur kështu konsumatorin dhe tregun vendor.

Veprimtaria dytësore

Si veprimtari dytësore planifikohet edhe shkatërrimi i materialeve të plastikës dhe xhamit.

Materialet e plastikës do të futen në shrederr (copëtues), duke u copëtuar në grimca të vogla, të papërshtatshme për rikthim në treg si produkt i plotë. Materialet prej xhami do të kalojnë në makineri të posaçme që i thyejnë dhe i bëjnë të paqëndrueshme për përdorim të mëtejshëm.

Pas shkatërrimit, plastika dhe xhami mund të destinohen për riciklim, duke iu dhënë përdorim industrial si lëndë e parë për klientin. Procesi do të kryhet gjithmonë nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore.

Në rastin e plastikës dhe xhamit, materiali i copëtuar do të dërgohet për riciklim në përputhje me ligjet për mbrojtjen e mjedisit dhe parimet e ekonomisë qarkore. Do të respektohen standardet ndërkombëtare të sigurisë industriale, duke mbrojtur shëndetin e punëtorëve dhe mjedisin.

5. Ndikimet e Identifikuara Mjedisore dhe Masat për Minimizimin e Ndikimeve

Përveq ndikimeve pozitive ekonomike që vijnë nga aktivitetet dhe funksionalizimi i biznesit për shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit “Kastriot Dibra” B.I., që japin një kontribut të madhë në shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit që konfiskohet nga autoritetet shtetërore, kryesisht nga Dogana dhe inspektoratet përgjegjëse.

Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime. Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin ideor të konceptuar e të diskutuar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është duke funksionuar biznesi. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferën) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative). Në objektin e biznesit “Kastriot Dibra” B.I. mbetjet janë minimale.

Më poshtë janë paraqitur analiza veç e veç për secilin faktor mjedisor:

Ndikimet në ajër

Procesi i shkatërrimit mekanik nuk përfshin djegie apo përdorim kimik, prandaj emetimet janë minimale. Megjithatë, gjatë operimit të makinave për copëtim mund të krijohen pluhur tekstili dhe fibra të imta që ndikojnë në cilësinë e ajrit brenda hapësirave të punës dhe përreth objektit. Këto grimca mund të shkaktojnë shqetësime respiratore për punëtorët dhe të ndikojnë në cilësinë e ajrit lokal. Përveç kësaj, përdorimi i mjeteve transportuese dhe ngarkim-shkarkimi i materialeve

kontribuon me emetime të gazrave nga karburantet.

Ndikimet në ujë

Ky aktivitet nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me trupat ujqorë, por ekziston rreziku që pluhurat apo mbeturinat e tekstilit të shpërndahen në ujëra përmes sistemit të kanalizimit, sidomos nëse mbetjet nuk menaxhohen siç duhet. Larja e ambientit me ujë për pastrim mund të gjenerojë ujëra të ndotura me fibra dhe ngjyra që, në rast se derdhen në kanalizim pa trajtim paraprak, mund të ndikojnë në cilësinë e ujërave sipërfaqësore ose në rrjetin e kanalizimit publik.

Ndikimet në tokë

Nëse mbetjet tekstile dhe ato të plastikës e xhamit nuk deponohen dhe riciklohen sipas standardeve, mund të shkaktojnë ndotje të tokës. Shpërndarja e mbetjeve joorganike në terren e bën tokën më pak pjellore dhe më të vështirë për përdorime të ardhshme. Gjithashtu, mbetjet plastike dhe sintetike kanë jetëgjatësi të lartë dhe mund të kontribuojnë në ndotje afatgjatë të tokës.

Ndikimet në biodiversitet

Edhe pse zona nuk përfshihet në ndonjë zonë të mbrojtur natyrore, menaxhimi i dobët i mbetjeve mund të ndikojë indirekt në biodiversitetin përreth. Pluhurat, mbetjet tekstile apo plastike, dhe fragmentet e xhamit mund të përfundojnë në hapësira natyrore, duke rrezikuar shpendët, kafshët e vogla dhe habitatet lokale. Gjithashtu, përhapja e mbetjeve joorganike rrezikon florën dhe faunën duke dëmtuar ekosistemet përreth zonës së biznesit.

Trajtimi dhe deponimi i mbeturinave

Procesi i shkatërrimit mekanik gjeneron mbetje kryesisht nga tekstili i copëtuar, plastika dhe xhami. Nëse këto mbetje nuk menaxhohen sipas standardeve ligjore, ekziston rreziku i ndotjes së tokës dhe ujërave përreth, si dhe krijimit të hapësirave të pasigurta. Për këtë arsye, pronari i biznesit ka nënshkruar kontratë me Kompaninë e Menaxhimit të Deponive të Kosovës (KMDK), për grumbullimin e tekstilit të copëtuar. KMDK është një ndër kompanitë e licencuara nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës për grumbullimin, transportin dhe menaxhimin e mbeturinave. Si operator i autorizuar, ajo vepron në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i cili përcakton kriteret dhe standardet që duhet të plotësojnë subjektet që merren me këtë veprimtari.

Kompania posedon lejet e nevojshme mjedisore dhe licencat për të kryer shërbimet e saj në mënyrë të sigurt dhe në harmoni me rregullat ligjore për mbrojtjen e mjedisit.

Sipas U.A. Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave, mbeturinat e krijuara nga shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit kategorizohen në katalog me si jo të rrezikshme si në tabelën më poshtë:

Table 1 Ndarja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror të mbeturinave

Mbeturina sipas kodit	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
04 01	Mbeturinat nga industria e lëkurës dhe gëzofit	Të pa rrezikshme	Kontratë për grumbullim me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.
04 01 01	Mbeturina nga rrepja dhe prerjet	Të pa rrezikshme	Kontratë për grumbullim me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.
04 02	Mbeturinat nga industria e tekstilit	Të pa rrezikshme	Kontratë për grumbullim me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.
04 02 22	Mbeturinat e fibrave të tekstilit të përpunuar	Të pa rrezikshme	Kontratë për grumbullim me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.
20 01 02	Qelqi	Të pa rrezikshme	Kontratë për grumbullim me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës –Reciklim.
20 01 39	Plastika	Të pa rrezikshme	Kontratë për grumbullim me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës – Reciklim.

Grumbullimi i pakontrolluar i tyre rrit edhe rrezikun nga zjarri, duke qenë se tekstili dhe plastika janë material shumë të djegshëm.

Zhurma

Procesi i shkatërrimit mekanik të veshjeve dhe tekstilit nëse planifikon të përfshij edhe përdorimin e makinerive copëtuese, shrederëve dhe pajisjeve për trajtim të plastikës dhe xhamit mund të gjenerojnë nivele të zhurmës të përqendruara kryesisht brenda objektit. Zhurma e vazhdueshme ndikon negativisht tek punëtorët duke shkaktuar lodhje, stres dhe probleme me dëgjimin nëse ekspozimi është i gjatë. Përveç makinerive, edhe aktivitetet e transportit (ngarkim, shkarkim dhe lëvizja e automjeteve) kontribuojnë në rritjen e nivelit të zhurmës.

Zjarri

Mbetjet tekstile, plastike dhe paketimet e tyre janë material lehtësisht i djegshëm. Nëse nuk ruhen dhe menaxhohen sipas rregullave të sigurisë, ekziston rreziku i përhapjes së zjarreve. Këto zjarre mund të shkaktojnë ndotje të madhe të ajrit nga tymi dhe gazrat toksikë, si dhe të rrezikojnë sigurinë e punëtorëve dhe komunitetit përreth.

6. Masat për Zbutjen e Ndikimeve Mjedisore

Masat për zbutjen e ndikimeve negative të projektit në mjedis janë qenësore për minimizimin e dëmeve dhe promovimin e qëndrueshmërisë gjatë zhvillimit të projektit.

Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis për biznesin për shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit në komunën e Fushë Kosovës, janë identifikuar disa rreziqe mjedisore minimale që ndërlidhen me realizimin e projektit. Andaj pas identifikimit do të trajtohen ndikimet dhe do të parashtrohen masat që do të ndërmerrën për zbutjen e këtyre ndikimeve.

Këto ndikime janë të ndërlidhura me aktivitetet e përgjithshme të zhvillimit të biznesit ku përfshihet faza e operimit.

Në tabelën në vijim janë përmbledhur ndikimet mjedisore të projektit në raport me fazat e realizimit të tij.

Table 2 Masat e nevojshme për Mbrojtjen e Mjedisit

KOMPONENTA MJEDISORE	VEPRIMI QË SHKAKTON NDIKIMIN NEGATIV NË MJEDIS	MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
AJRI	➤ Gjenerim i pluhurit të tekstilit dhe fibrave të imta gjatë procesit të copëtimit. ➤ Emisione të gazrave nga përdorimi i mjeteve transportuese për ngarkim dhe shkarkim.	✓ Ventilim i brendshëm. ✓ Mirëmbajtja e rregullt e makinave dhe mjeteve transportuese për të ulur emetimet. ✓ Përdorimi i maskave mbrojtëse për punëtorët.
UJI	➤ Rreziku i përzierjes së fibrave tekstile dhe ngjyrave në ujërat e kanalizimit gjatë pastrimit.	✓ Parandalimi i derdhjes së mbeturinave në kanalizim.
TOKA	➤ Ndotje e mundshme nga mbetjet tekstile, plastike dhe xhami nëse nuk menaxhohen siç duhet. ➤ Humbje e pjellorisë së tokës dhe ndotje afatgjatë nga materialet sintetike.	✓ Riciklim i materialeve të plastikës dhe xhamit për të shmangur ndotjen e terrenit. ✓ Kontroll i rregullt i hapësirës së punës për të parandaluar shpërndarjen e mbeturinave.
BIODIVERSITETI	➤ Fragmentet e xhamit dhe plastikës mund të dëmtojnë habitatet lokale.	✓ Riciklim dhe transport në mënyrë të sigurt nga kompani të licencuara. ✓ Monitorim periodik i zonës përreth për të parandaluar shpërndarjen e mbetjeve.

MBETURINAT	➤ Gjenerim i mbetjeve tekstile, plastike dhe xhami që mund të kontaminojnë tokën dhe ujërat. - Grumbullimi i pakontrolluar rrit rrezikun nga zjarri.	✓ Zbatim i kontratës me KMDK për grumbullim dhe transport të mbeturinave. ✓ Ndarje në burim sipas katalogut shtetëror të mbeturinave (tekstil, plastikë, qelq). ✓ Riciklim i plastikës dhe xhamit, deponim i kontrolluar i tekstit.
ZHURMA	➤ Zhurmë nga makineritë copëtuese dhe shrederët gjatë procesit.	✓ Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse për dëgjim për punëtorët.
ZJARRI	➤ Tekstili dhe plastika janë materiale lehtësisht të djegshme. ➤ Rrezik i lartë për përhapjen e flakëve dhe ndotje të ajrit nga tymi toksik.	✓ Pajisja e objektit me sisteme kundër zjarrit (alarme, shishe zjarrfikëse, hidrante). ✓ Ruajtja e mbetjeve në hapësira të mbyllura dhe të sigurta.
SHËNDETI I POPULLATËS	➤ Ekspozimi i punëtorëve ndaj pluhurit tekstil dhe fibrave të imta mund të shkaktojë probleme respiratore, alergji dhe shqetësime në rrugët e frymëmarrjes. ➤ Zhurma e vazhdueshme nga makineritë dhe mjetet transportuese mund të ndikojë në shëndetin e punëtorëve duke shkaktuar stres, lodhje dhe dëmtime të dëgjimit.	✓ Përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse (maskë, doreza, syze mbrojtëse, mbrojtëse për veshët). ✓ Ventilim i mjaftueshëm i hapësirës së punës dhe pastrim i rregullt i saj për të reduktuar pluhurin. ✓ Monitorim periodik i kushteve të punës dhe kontrole shëndetësore për punëtorët.

	➤ Rreziku nga aksidentet e punës (prerje nga pajisjet, lëndime nga thyerja e xhamit, trauma nga makineritë). ➤ Në rast të menaxhimit jo të duhur të mbeturinave ose zjarrit, ndotja e ajrit me tym e gazra toksike mund të ndikojë edhe tek komuniteti përreth.	
--	--	--

7. Konkluzione dhe rekomandime

Nga analiza e realizuar në kuadër të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për biznesin “Kastriot Dibra” B.I., rezulton se aktiviteti i shkatërrimit mekanik të veshjeve dhe tekstilit të konfiskuar ka një ndikim minimal në mjedis, për shkak se procesi nuk përfshin djegie, përdorim kimik apo shkarkime direkte në ujëra dhe tokë. Ndikimet kryesore lidhen me krijimin e pluhurit tekstil dhe fibrave të imta, menaxhimin e mbeturinave, zhurmën, si dhe rrezikun nga zjarri për shkak të natyrës së materialeve (tekstil dhe plastikë).

Përmes kontratës së nënshkruar me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK), trajtimi i mbeturinave sigurohet të bëhet në përputhje me legjislacionin mjedisor. Gjithashtu, riciklimi i materialeve të plastikës dhe xhamit kontribuon në uljen e mbeturinave të deponuara dhe në nxitjen e ekonomisë qarkore.

Në aspektin socio-ekonomik, projekti ka ndikim pozitiv për shkak se ofron transparencë në trajtimin e mallrave të konfiskuara, mbron konsumatorin nga rikthimi i produkteve të dëmshme në treg dhe siguron vende pune.

Rekomandohet që:

- Të përdoren sisteme të ventilimit dhe filtrimit të pluhurit; punëtorët të pajisen me maska dhe mbrojtëse për dëgjim; makineritë të mirëmbahen rregullisht për të ulur emetimet dhe zhurmën.
- Të shmangët derdhja e ujërave të pastrimit në kanalizim pa trajtim paraprak; mbetjet të mos deponohen në hapësira të hapura, por të grumbullohen sipas standardeve.
- Të respektohet kontrata me KMDK dhe ndarja në burim sipas katalogut shtetëror të mbeturinave; plastika dhe qelqi të riciklohen, ndërsa tekstili të deponohet në mënyrë të kontrolluar.
- Objekti të pajiset me sisteme mbrojtjeje (alarme, shishe zjarrfikëse, hidrante).
- Të sigurohen kushte pune të sigurta, me ndriçim dhe ventilim adekuat.
- Të implementohet plan i rregullt monitorimi mjedisor dhe të raportohen të gjitha aktivitetet sipas kërkesave ligjore për pëlqim mjedisor.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE E PROJEKTIT

Biznesi “Kastriot Dibra” B.I. në Fushë Kosovë merret me shkatërrimin mekanik të veshjeve dhe tekstilit të konfiskuar nga Dogana dhe inspektoratet e Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij aktiviteti është që mallrat e konfiskuara të bëhen të papërdorshme dhe të mos rikthehen në treg, duke mbrojtur kështu konsumatorin dhe sigurinë e tregut. Procesi i shkatërrimit bëhet me gërshërë dhe makineri mekanike, në prani të autoriteteve shtetërore, dhe pas çdo procedure lëshohet certifikatë zyrtare e shkatërrimit. Si veprimtari dytësore, biznesi trajton edhe materiale plastike dhe xhami, të cilat copëtohen dhe më pas dërgohen për riciklim.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis tregon se aktiviteti nuk përfshin djegie apo përdorim kimik, prandaj ndotja e ajrit dhe ujit është minimale. Ndikimet e identifikuara lidhen kryesisht me pluhurin, menaxhimin e mbeturinave, zhurmën dhe rrezikun nga zjarri. Për këtë arsye, janë propozuar masa për zbutje si: ventilimi i brendshëm, riciklimi i materialeve, deponimi i kontrolluar i mbeturinave, pajisja e objektit me sisteme kundër zjarrit dhe sigurimi i pajisjeve mbrojtëse për punëtorët.

Në përgjithësi, projekti ka ndikime pozitive ekonomike dhe sociale, duke ofruar punësim dhe duke kontribuar në mbrojtjen e tregut vendor nga produktet e konfiskuara. Zbatimi i masave të propozuara dhe monitorimi i rregullt mjedisor sigurojnë që aktiviteti të jetë i qëndrueshëm dhe në përputhje me ligjet e mbrojtjes së mjedisit në Kosovë.

Shtojcat

Në vijim është lista me dokumentet shtesë që do t'i bashkangjiten këtij Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis nga ana e aplikuesit, sipas Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 13, paragrafi 2.

- Pëlqimin e Komunës për ushtirimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës zonale, kushtet ndërtimore.
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit
- Fleta Poseduese (Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluejtshme).
- Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref
- Plani i rilevimit të terrenit nga Gjeodeti i licensuar
- Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e kërkuarit për pëlqim mjedisor
- Dëshminë e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor
- Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit
- CD